

PROGRAM I PËRBASHKËT STUDIMI BACHELOR NË “MENAXHIM DIGJITAL”

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë e dyfishtë Bachelor në “Menaxhim Digjital”
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Në proces akreditimi
Cikli i studimit	Cikli i parë
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti Ekonomik, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip dhe anglisht
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njëhësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollë së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Menaxhimi Digjital është të aftësojë studentët me njohuri teorike të përgjithshme të fushës së menaxhimit si dhe me ato specifike të digjitalizimit. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit të jenë të pajisur me:

- Njohuri themelore në kalkulimin dhe zgjidhjen e problemeve në biznese.
- Njohuri të nevojshme në fushën e menaxhimit dhe marketingut.
- Njohuri të nevojshme mbi programet kompjuterike financiare.

- Njohuri mbi organizimin dhe legjislacionin në fushën e veprimtarisë tregtare.
- Njohuri themelore në fushën e kontabilitetit.
- Njohuri themelore në fushën e financës.
- Njohuri themelore në fushën e sektorit bankar.
- Njohuri në fushën e sistemit tatimor.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit në menaxhimin digjital.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi analitike, menaxheriale dhe komunikimi që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin institucional, publik apo ndërsektorial në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të politikave publike dhe ekonomisë digjitale, ekonomisë së inovacionit, menaxhimit të biznesit digjital, raportimit financiar të korporatës etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

- 1. Lëndë të formimit të përgjithshëm** (*Ekonomi Biznesi, Bazat e së Drejtës dhe Inovacioni Teknologjik, Matematikë Biznesi, Parimet e Ekonomisë*) **Kredite 34 ECTS**
- 2. Lëndë të formimit karakterizues** (*Statistika dhe analiza e të dhënave, Teknologji digjitale, Banka digjitale dhe fintech, Ekonomia e inovacionit, Menaxhimi i biznesit digjital (moduli I), Menaxhimi i biznesit digjital (moduli II), Raportimi financiar i korporatës, Parimet e ekonometrisë, "Machine learning" në menaxhim, Inovacioni bankar dhe financiar ne korporata, Informacioni dhe Ekonomi Biznesi, Organizimi dhe menaxhimi i njohurive, Politika publike dhe ekonomia digjitale*) **Kredite 94 ECTS**
- 3. Lëndë integruese** (*Aktivitete Fakultative*) **Kredite 12 ECTS**
- 4. Lëndë me zgjedhje** (*E drejtë biznesi, Rregullimi i tregjeve digjitale dhe big data, E drejta tatimore e ekonomisë digjitale*) **Kredite 12 ECTS**
- 5. Lëndë të formimit plotësues** (*Gjuhë Angleze, Big Data, Praktikë Profesionale*) **Kredite 19 ECTS**
- 6. Intership dhe Provim formimi** **Kredite 9 ECTS**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45-54 pikë
6 (gjashtë)	55-64 pikë
7 (shtatë)	65-74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë“Bachelor” nëMenaxhim Digjital është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë“Bachelor” në Menaxhim Digjital është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitëe një tregu pune dinamik, të globalizuar dhe gjithnjë në transformim, veçanërisht në sektorin e menaxhimit e digjitalizimit si dhe fushat ndërdisiplinore që lidhen me to.

Studenti i cili diplomohet në programin e dyfishtë të studimit “Bachelor” në Menaxhim Digjital mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytëbazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit.

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë në fushën e Menaxhimit Digjital, të kualifikuar me njohuri të tilla si menaxhim i biznesit digjital, menaxhim i marrëdhënieve me klientët, menaxhim strategjik, rregullimi i tregjeve digjitale, ekonomia dhe inovacioni, marketingu digjital, politika publike dhe ekonomia digjitale, banka digjitale dhe fintech, organizimi dhe menaxhimi i njohurive, etj. Për këtë arsye synimi i programit të studimit Bachelor në Menaxhim Digjital është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar ose "Menaxherë digjitalë", siç mund të quhen studentët pas diplomimit mund të punësohen veçanërisht në fusha që kërkojnë të nxisin avancimin dixhital. Misioni i tyre është të zhvillojnë mundësi të reja biznesi përmes teknologjive digjitale të informacionit dhe t'i bëjnë strukturat jo efektive më efikase duke zgjeruar teknologjitë digjitale. Qëllimi është të përdoren mundësitë e digjitalizimit për të krijuar vlerë të shtuar për klientët, punonjësit, kompanitë dhe shoqërinë, dhe njëkohësisht të sigurohet qëndrueshmëri në të ardhmen e kompanive apo bizneseve.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit "Bachelor" në Menaxhim Digjital fitojnë njohuri në menaxhimin e biznesit digjital, menaxhimin e marrëdhënieve me klientët, menaxhimin strategjik, rregullimin e tregjeve digjitale, ekonominë dhe inovacionin, marketingun digjital, politikat publike dhe ekonominë digjitale, bankat digjitale dhe fintech, organizimin dhe menaxhimin e njohurive, etj.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Ekonomi Biznesi	12	150	I+II
2.	Bazat e së Drejtës dhe Inovacioni Teknologjik	6	60	II
3.	GjuhëAngleze	6	60	II
4.	Matematikë Biznesi	8	75	I
5.	Parimet e Ekonomisë	8	75	I
6.	Statistika dhe analiza e të dhënave	12	90	I
7.	Teknologji digjitale	8	75	II
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	585Orë	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Banka digjitale dhe fintech	8	75	I
2.	Big Data	8	75	I

Lende me zgjedhje (2 nga 3)				
3.	<i>Rregullimi i Shoqërive Tregtare</i>	6	60	II
4.	<i>Rregullimi i tregjeve digjitale dhe big data</i>	6	60	I
	<i>E drejta tatimore e ekonomisë digjitale</i>	6	75	I
5.	Ekonomia e inovacionit	8	75	I
6.	Menaxhimi i biznesit digjital (moduli I)	6	60	II
7.	Menaxhimi i biznesit digjital (moduli II)	6	60	II
8.	Raportimi financiar i korporatës	6	60	II
9.	Parimet e ekonometrisë	8	75	II
Gjithësej viti i dytë		62 ECTS	480Orë	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i tretë				
1.	Aktivitete Fakultative	12	75	II
2.	"Machine learning" në menaxhim	6	60	I
3.	Inovacioni bankar dhe financiar ne korporata	8	75	II
4.	Informacioni dhe Ekonomi Biznesi	6	60	I
5.	Organizimi dhe menaxhimi i njohurive	6	60	I
6.	Politika publike dhe ekonomia digjitale	6	60	I
7.	Intership	6	60	I
8.	Praktikë Profesionale	5	60	II
9.	Provim formimi	3	30	II
Gjithësej viti i tretë		58 ECTS	540	

Total : viti I + viti II + viti III	180 ECTS	1605 Orë	
--	-----------------	-----------------	--